



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikolinguistikë

Ngarkesa: kredite; 40 orë mësimore: 30 leksione, 10 seminare;

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në “Mësuesi”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat të përgjithshëm lëndore:

Kjo lëndë zhvillon te studentët aftësinë: për të ushtruar një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e materialeve të ndryshme; për të përzgjedhur dhe t’iu referuar një bibliografie shkencore të mirëfilltë; për të ushtruar dhe komunikuar me gojë dhe shkrim problemet teorike që lidhen me psikologjinë në fushën linguistikës në përgjithësi. për të argumentuar e psikologjisë në mësimin e gjuhës amtare dhe asaj të huaj. për të provuar ndikimin e gjuhës amtare në kuptimin e gjuhës së huaj të dëgjuar dhe të lexuar.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ndërmarrin studime të mëtijshme në kuadër të punimeve të ndryshme shkencore;
 2. Të zhvillojnë kompetencën e arsytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive përmes sistemimit të njohurive, përzgjedhjes së materialeve, pjesëmarrjes në diskutime dhe paraqitjes së projekteve të ndryshe gjatë mësimin përpara kursit;
 3. Të formulojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre si dhe të nxjerrin përfundimet përkatëse;
 4. Të reflektojnë shkencërisht mbi fenomenet psikolinguistike dhe ndikimet e tyre në përvetësimin dhe përpunimin e gjuhës;
- të identifikojnë, analizojnë dhe zgjidhin probleme në fushën e përpunimit dhe përvetësimit të gjuhës bazuar në njohuritë psikolinguistike.

Rezultate të pritshme:

Kursi synon t’u japë studenteve njohuri mbi psikolinguistikën në përgjithësi dhe atë të mësimin të gjuhëve të huaja në veçanti. Kursi synon gjithashtu që studentët të krijojnë shprehje në përdorimin e njohurive të tyre në evidentimin e problemeve që lidhen me mësimdhënien e nxënien e gjuhëve të huaja nga këndvështrimi i psikologjisë. Njohuri mbi mekanizmat njohës që luajnë rol në perceptimin e gjuhës, të folurit, dëgjimin, leximin dhe shkrimin. Njohuri mbi dallimet midis përvetësimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj dhe faktorët që ndikojnë në këtë proces